**NAIM BERISHA**

## GJASHTËDHJETË VJET PËRPJEKJE PËR STUDIMIN E GJUHËS SHQIPE NË INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS

Në qershorin e këtij viti (2013) u mbushën plot 60 vjet që nga themelimi i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Puna e palodhshme kërkimore dhe shkencore e punonjësve të këtij institucioni, ka bërë që studimet albanologjike në Kosovë të avancojnë vazhdimisht me rezultate të reja shkencore. Që nga themelimi e këtej, për plot 60 vjet, Instituti Albanologjik i Prishtinës ishte tribuna më e kualifikuar e mendimit shkencor në fushë të albanologjisë. Në këtë kumtesë, do të mundohemi të paraqesim një pasqyrë të shkurtër rreth veprimtarisë shkencore të këtij institucioni. Fokusi ynë kryesor do të jenë botimet e shumta dhe me interes në revistat shkencore "Gjurmime albanologjike-seria e shkencave filologjike" dhe "Gjuha shqipe", botimi i të cilave ka luajtur një rol të rëndësishëm në studimet gjuhësore në përgjithësi.

Siç e dimë, në revistën "Gjurmime albanologjike" për shumë vjet me radhë, nga studiues të shumtë janë nxjerrë rezultate të reja shkencore nga fusha të ndryshme të gjuhësisë dhe të letërsisë, ndërsa në revistën "Gjuha shqipe" janë trajtuar kryesisht tematika që lidhen me probleme të ndryshme të shqipes standarde.

Po kështu, ngjarjet "e rëndësisë së veçantë" të cilat i ka organizuar Instituti Albanologjik si "Konsulta Gjuhësore e Prishtinës 1968", nuk mund të lihen pa u përmendur. Jo pa arsye po e kujtojmë se Konsultën Gjuhësore të Prishtinës e organizoi Instituti Albanologjik. Ajo ishte paraprijëse e Kongresit të Drejtshkrimit, e cila e bëri të mundshme që ky Kongres të jetë gjithëkombëtar dhe ta ketë vlerën të cilën e ka edhe sot.

Nga shumëkush është konstatuar se studimet gjuhësore në Kosovë, mirëfilli kanë nisur pas luftës së dytë botërore. Në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të kulturës, u krijuan rrethana të favorshme edhe për shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Në këtë kontekst, rol të madh për studimet gjuhësore ka luajtur botimi i revistës shkencore "Gjurmime Albanologjike". Kjo revistë filloi të botohet në vitin 1962. Në fillim u botua si organ i fakultetit Filozofik në kuadër të cilit u botuan 3 numra. Në vitin 1968, revista filloi të botohet nga Instituti Albanologjik, institucion i cili filloi ta botojë dy herë në vit. Në vitin 1971 revista "Gjurmime Albanologjike" filloi të botohej në tri seri, seria e shkencave filologjike, seria e shkencave historike, seria folklor etnologji. Dalja në dritë e "Gjurmimeve Albanologjike" hapi shtigje të reja për studime

të shqipes në përgjithësi[1]. Hapja e këtyre shtigjeve kishte një rëndësi të madhe dhe një domethënie të veçantë, sepse, përveç kontributeve shumë të çmuara nga studiuesit më të dëshmuar të gjuhësisë dhe të letërsisë, botimi i kësaj reviste kishte rëndësi të madhe edhe ne aspektin kombëtar, si organ ku bashkoheshin mendjet më të ndritura të kombit.

Studimeve gjuhësore në revistën gjurmime Albanologjike u priu prof. Idriz Ajeti me kumtesën me titull "Nastariji dokument kosovskog arbanaškog govora na arapskom pismo" (Dokumenti më i vjetër i së folmes shqipe të Kosovës me alfabetin arab). Për shumë vite me radhë, prof. Ajeti në vazhdimësi botoi studime që lidheshin me shumë disiplina gjuhësore. Duhet veçuar studimi i botuar në numrin e tretë të revistës "Gjurmime albanologjike", "Mbi gjuhën e divanit të Sheh Maliqit". Në këtë studim, Idriz Ajeti konstaton ekzistencën e një varg veçorish, të cilat sipas tij gjallëronin në Kosovë, në kohën kur jetoi e punoi Sheh Maliqi, siç janë: diferencimi i plotë i palataleve nga ato afrikate q-ç, gj-xh, zëvendësimi i së tashmes së lidhores, përdorimi alternativ i foljeve kam dhe jam etj.[2]

Kur themi se me botimin e kësaj reviste, Instituti Albanologjik i Prishtinës i bashkoi mendjet më të ndritura të kombit, kjo gjë vërtetohet lehtë. Duhet veçuar edhe studimin e prof. Eqrem Çabejt me titull "Dy çështje Gjuhësore[3]". Në këtë studim, prof. Çabej, duke i argumentuar mjaft mirë, trajton disa mendime mbi nazalizimin e shqipes. Çështja e dytë të cilën e trajton prof. Çabej është emërtimi i toponimit "Gjerbës", duke polemizuar me Max Vasmerin, sjell kundërargumente shkencore se ky toponim nuk është me prejardhje nga sllavishtja por nga shqipja.

Në revistën "Gjurmime Albanologjike" janë botuar kontribute nga studiues të mëdhenj të gjuhësisë shqiptare. Duhet përmendur, Eric Hamp, Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Wilfrid Fidler, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Selman Riza, Hilmi Agani e shumë të tjerë.

Në këtë revistë nuk kanë munguar studimet e gjuhëtarëve të tjerë të shquar si: Emil Lafe, Rexhep Ismajli, Jani Thomai, Latif Mulaku, Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Mehmet Halimi Gjovalin Shkurtaj, Ragip Mulaku, Bahri Beci, Ibrahim Goçi, Shefkije Islamaj, Mehmet Ahmataj, Tomor Osmani, Rexhep Doçi, Valter Memisha, Qemal Murati, Adelina Çerpja, Anila Çepani, Naser Pajaziti, etj.

Meqenëse në revistën "Gjuha shqipe" janë trajtuar kryesisht tematika që lidhen me shqipen standarde, edhe fokusimi ynë në këtë kumtesë do të jetë i orientuar në këtë drejtim.

---

[1] Naser Pajaziti, *Studimet dialektologjike në revistën "Gjurmime Albanologjike*", Prishtinë, 2004.

[2] Po aty…

[3] Eqrem Çabej, *Dy çështje gjuhësore*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1978.

Revista "Gjuha shqipe", për vite me radhë ishte tribuna më e kualifikuar e mendimit shkencor mbi standardin gjuhësor të shqipes. Falë kontributit të studiuesve e dashamirëve të punës shkencore, studimet mbi standardin dhe debatet mbi të janë trajtuar në masë të konsiderueshme, duke krijuar një bazë të mirë argumentesh shkencore rreth problemeve që diskutohen. Revistën "Gjuha shqipe", Instituti Albanologjik e boton që nga viti 1982.

Varësisht nga viti në vit, kjo revistë ka këto rubrika: studime dhe artikuj, gjuha në praktikë, diskutime, kritika dhe recensione, pyetje e përgjigje, kumtesa, këshilla gjuhësore, gjuha letrare dhe shqetësimi ynë, bisedë, fjala e rrallë shqipe, materiale, fjalor me emra njerëzish, kronika, redaksia, përvjetorë dhe bibliografia[4].

Edhe studimeve mbi standardin në revistën "Gjuha shqipe" u priu profesor Idriz Ajeti. Numri i parë i kësaj reviste hapet me studimin e profesor Ajetit " *Për përdorimin e drejtë të disa trajtave foljore*"[5]. Në këtë studim autori vë në pah përdorimin jo të drejtë të disa foljeve në emisionet televizive dhe në publicistikë.

Ndër studimet e para të botuara në revistën "Gjuha shqipe" është edhe studimi i Shefkije Islamajt "*Mjetet shprehëse dhe norma letrare*"[6] , ku trajtohen disa çështje të sinonimisë në raport me normën. Një studim mjaft serioz është edhe punimi "*Përdorimi i shqipes standarde në mjetet e informimi"*. Autorja Islamaj çështjen e ngritur e vështron në disa anë: *informimi publik, gjuha letrare, mjetet e informimit etj.* Aty trajtohen një nga një çështjet e ngritura, sjellë shembuj konkret të deformimit gjuhësor nga mjetet e informimin duke dhënë propozime konkrete për mbrojtjen e standardit nga deformimet që i bëhen.

Interesimi dhe puna për mbrojtjen dhe kultivimin e gjuhës standarde nuk kanë munguar qysh herët. Në numrin e dytë të revistës "Gjuha shqipe" duhet veçuar studimi "*Disa gabime gjuhësore në shtypin tonë*"[7] i autorit Ragip Mulaku. Në këtë studim autori vë në pah disa gabime gjuhësore që shfaqen në shtypin e atëhershëm, kryesisht në gazetën e përditshme "Rilindja". Një studim tjetër me interes është "*Reflektime për shqipen standarde"*[8], i po këtij

[4] Emine Fetahu, *Bibliografia e punimeve të revistës "Gjuha shqipe*" 1982-2009, Gjuha Shqipe, nr. 3, Prishtinë, 2009, f. 93.

[5] Idri Ajeti, *Për përdorimin e drejtë të disa trajtave foljore*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 1982, nr. 1. f. 5-6.

[6] Shefkije Islamaj, *Mjetet shprehëse dhe norma letrare*, "Gjuha shqipe", Prishtinë,1982, nr. 1.

[7] Ragip Mulaku, *Disa gabime gjuhësore në shtypin tonë*, "Gjuha jonë", Prishtinë, 1983, nr. 1.

[8] Ragip Mulaku, *Reflektime për shqipen standarde*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2010, nr. 2.

autori. E veçanta e këtij studimi është se autori jep argumente të vlefshme pse duhet ruajtur ky standard që e kemi. Duke sjell shembuj nga formimi i standardit gjuhësor edhe në gjuhët tjera të botës, autori padiskutueshëm e mbron këtë standard, duke konstatuar se gjuha letrare tashmë ka hyrë në të gjitha fushat e jetës sonë, i ka mënjanuar variantet dialektore dhe e ka përmbushur me sukses misionin e saj.

Kontribut tjetër i çmuar është studimi *"Shqipja standarde dhe problemet rreth saj"*[9]*)*, i autorit Isa Bajçinca. Studimi në fjalë trajton mjaft argumentueshëm shumë çështje që diskutohen rreth standardit të shqipes. Duke dhënë sqarime rreth pyetjes se a është gjuha "*letrare apo standarde"* autori shkruan për disa nga tiparet që e karakterizojnë gjuhën standarde. Qëndrimin për mbrojtjen e këtij standardi autori i argumenton mjaft mirë, me një përmbledhje të shkurtër se si u krijua shqipja standarde, flet për variantin që përdorej asokohe në Kosovë dhe a mund të përdorej ndonjë tjetër variant letrar?, si u shtrua dhe si u bë njësimi i shqipes?, etj. Studimi vazhdon me trajtimin e disa problemeve aktuale të shqipes, për të diskutuar për shqipen standarde në kohët e fundit.

Një tjetër studim që duhet veçuar është punimi "*Për mbrojtjen e shqipes nga "ndotjet" që i vijnë nga të gjitha anët"*[10] me autor Qemal Muratin. Autori në fillim të punimit e përkrah rektorin e Universitetit të Prishtinës për futjen e gjuhës shqipe si lëndë të obligueshme në të gjitha drejtimet e UP-së. Ai e quan "Ogur të mirë" këtë vendim dhe e argumenton me fakte këtë. Në vazhdim të studimit shtjellohen raste të ndotjes gjuhësore në gjuhën e administratës publike, në medie etj., të cilat argumentohen me shembuj konkret. Punimi vazhdon me trajtimin e problemeve gjuhësore në praktikë, çështje si: *fjalë me kuptime të gabueshme, fjalë të huaja e të panevojshme, përdorimi i gabuar disa trajtave foljore, gabime në përdorimin e përemrave lidhorë etj.*

Nuk duhet lënë pa përmendur edhe studimi *"Rrezik serioz i rrëshqitjes në kaos"*[11] i Rexhep Ismailit. Studimi në fjalë trajton çështje praktike të përdorimit të shqipes standarde në administratën publike. Duke e trajtuar përdorimin e shqipes në administratën publike në raport me anglishten si gjuhë zyrtare e UNMIK-ut, autori vë në pah kriteret e degraduara në përdorimin e shqipes si gjuhë e administratës dhe e jetës publike. Gjendjes së vështirë gjuhësore autori ia shton edhe një aspekt tjetër,q ë është 10 vjeçari i fundit i

[9] Isa Baiçinca, *Shqipja standarde dhe problemet rreth saj*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2007, nr. 1.

[10] Qemal Murati, *Për mbrojtjen e shqipes nga "ndotjet" që i vijnë nga të gjitha anët*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2010, nr. 3.

[11] Rexhep Ismaili, *Rrezik serioz i rrëshqitjes në kaos, "*Gjuha shqipe", Prishtinë, *2002.*

shekullit të kaluar, ku populli shqiptar i Kosovës u detyrua të merret me mbetjen gjallë dhe vetëm me të.

Vargu i gjuhëtarëve që kontribuuan me studimet e tyre në revistën "Gjuha shqipe" është i gjatë, duhet përmendur: Mehmet Halimi, Mehmet Gjevori, Shaqir Berani, Mehmet Ahmetaj, Latif Mulaku, Ibrahim Goçi, Rexhep Doçi, Naser Pajaziti, Adem Hajdaraj e shumë e shumë të tjerë.

Në revistën "Gjuha shqipe" nuk kanë munguar as studimet e gjuhëtarëve nga Shqipëria dhe Maqedonia. Studimet e tyre i kanë botuar gjuhëtarë të dëshmuar në gjuhësi si: Eqrem Çabej, Mahir Domi, Xhevat Lloshi, Fadil Sylejmani, Emil Lafe, Rami Memushaj, Edmond Tupja, Mehmet Çeliku, Valter Memisha, Jani Thomai, Menella Totoni, Shezai Rrokaj, Miço Samara, Raul Lilo, Remzi Nesimi etj.

Duhet veçuar studimi *"Për një gjuhë shqipe dinamike"*[12] i autorit Xhevat Lloshi. Trajtimin e kësaj çështjeje autori e fillon që nga viti 1972 kur u mbajt kongresi i drejtshkrimit. Periudhën pas vitit 1972 e quan politikë gjuhësore entuziaste, e cila vazhdoi deri në fillim të viteve 90-ta. Sipas autorit, shembjen e regjimit totalitar në Shqipëri e shoqëruan mendime se kjo duhej kryer edhe në fushë të gjuhës. Duke vënë në dukje kohën kur filluan debatet për standardin gjuhësor, autori shkruan se " librat, punimet, shkrimet, artikujt, diskutimet, në këtë lëmë kanë dy karakteristika themelore: e para ato shërbejnë për të përçuar politikën, por në mënyrë që ajo të bëhet e pranueshme, bindëse ose tërheqëse. E dyta, ato karakterizohen nga protagonizmi, domethënë autorët duan ta tregojnë vetën, të imponojnë vetën, të nxjerrin përfitime për veten sot dhe në perspektivën historike.

*Për s*tudimet mbi standardin ka kontribuar shumë edhe Jani Thomai. Studimi i tij *"Probleme të leksikut në shqipen standarde"*[13] trajton teorikisht një mori çështjesh të normës leksikore. Studimi në fjalë jep të dhëna të mira për këtë çështje. Aty jepen disa veçori që e karakterizojnë normën leksikore nga norma drejtshkrimore a gramatikore, norma fonetike etj. Sipas Jani Thomait, për shkak të çiltërsisë së vet, norma leksikore nuk mund të jetë e përcaktuar në mënyrë konkrete si norma drejtshkrimore, e as nuk ka kërkesa me atë rreptësi të normës në fonetikë a në gramatikë. Në këtë studim jepen edhe propozime konkrete për hapat që duhet të merren në të ardhmen si, pasurimi i leksikut të shqipes standarde dhe pastrimi i tij nga lënda e huaj e panevojshme, ngritja e një komisioni për shqipërimin e fjalëve të huaja, hartimi i fjalorëve elektronikë etj.

Në listën e studimeve që trajtojnë çështje mbi standardin, me interes është edhe punimi "*Standardi nuk është gjithëpërfshirje, por është*

[12] Xhevat Lloshi, *Për një gjuhë shqipe dinamike*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2001.
[13] Jani Thomai, *Probleme të leksikut në shqipen standarde*, "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2006, nr. 3.

*përzgjedhje"*[14] nga Valter Memisha. Ai e konsideron standardin gjuhësor si një e arritur e padiskutueshme, por nuk lë pa e përmendur se në procesin standardformues të shqipes është i njohur, tashmë, vendi dhe roli i Konsultës së Prishtinës (1968). Duke e trajtuar problemin e ngritur në këtë studim, autori sjell disa mendime të studiuesve që janë marrë më së shumti me planifikimin gjuhësor dhe me politikat gjuhësore. Në të njëjtën kohë e përshkruar si tronditëse tendencën për identifikimin e kufirit politik me atë gjuhësor, autori mendon se hapja më e madhe duhet të jetë në fushën e leksikut.

Mund të konstatojmë se studimet mbi shqipen standarde në revistën "Gjuha shqipe" paraqesin një bazë të mirë për zgjidhjen e problemeve gjuhësore me të cilat ballafaqohemi. Trajtimi i shumë çështjeve që kanë të bëjnë me këtë tematikë dhe sjellja e rezultateve të shumta shkencore, bënë që mendimi gjuhësor për problemet e standardit të jetë më i avancuar rreth këtyre çështjeve.

[14] Valter Memisha, *Standardi nuk është gjithëpërfshirje,* "Gjuha shqipe", Prishtinë, 2010, nr. 2.